



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

**RREGULLORE (QRK) NR. 28/2024 PËR PEZULLIMIN NGA
MARRËDHËNIA E PUNËS¹**

¹ Rregullore (QRK) Nr. 28/2024 për pezullimin nga marrëdhënia e punës, është miratuar në mbledhjen e 221-të, të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 08/221, të datës 23.09.2024.

Qeveria e Republikës së Kosovës, mbështetur në paragrafin 4 të nenit 93 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 69 dhe 70, të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenit 8, paragrafit 4, nënparagrafit 4.5 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe në pajtim me nenin 78, paragrafin 6, nënparagrafin 6.2 të Rregullores (QRK)- Nr. 17/2024 së Punës së Qeverisë të Republikës së Kosovës,

Nxjerr:

RREGULLORE (QRK) NR. 28/2024 PËR PEZULLIMIN NGA MARRËDHËNIA E PUNËS

Neni 1 Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e rregullave dhe procedurave për pezullimin nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil.

Neni 2 Fushëveprimi

1. Kjo Rregullore zbatohet për të gjitha kategoritë e nëpunësve civil në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet tjetra shtetërore.
2. Përjashtimisht, kjo Rregullore nuk zbatohet për nëpunësit në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet, termat dhe shkurtesat e përdorura në këtë Rregullore kanë këtë kuptim:
 - 1.1. **Funksionarë** – nënkupton funksionarët publik, siç është përcaktuar në shtojcën 1 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik;
 - 1.2. **LZP** – nënkupton Ligjin Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik.
2. Shprehjet, termat dhe shkurtesat tjera të përdorura në këtë Rregullore, kanë kuptimin e njëjtë si në Ligjin Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik.

Neni 4

Llojet e pezullimit

1. Pezullimi është ndërprerja e përkohshme e marrëdhënies së punës në shërbimin civil që bëhet:
 - 1.1. sipas detyrës zyrtare; apo
 - 1.2. me kërkesë të nëpunësit civil.

Neni 5

Pezullimi sipas detyrës zyrtare

1. Nëpunësit civil i pezullohet marrëdhënia e punës sipas detyrës zyrtare në këto raste:
 - 1.1. në rastin kur ndaj nëpunësit është iniciuar procedurë disiplinore dhe komisioni disiplinor vendos se vazhdimi i ushtrimit të detyrës nga nëpunësi civil, pengon hetimin disiplinor apo mund të cenoj ushtrimin e përshtatshëm të detyrës së tij.
 - 1.2. kur nëpunësi merr një funksion apo emërohet në një nga funksionet e mëposhtme:
 - 1.2.1. të zgjedhurit;
 - 1.2.2. anëtarët e Qeverisë dhe zëvendësit e tyre;
 - 1.2.3. funksionarët e emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, titullarët apo anëtarët e organeve drejtuese kolegjiale të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të agjencive të pavarura, përjashtimisht të emëruarit në pozitat e shërbimit civil;
 - 1.2.4. të emëruarit politik në nivelin qendror dhe lokal, përjashtimisht emërimin si zyrtar i kabinetit.
 - 1.3. transferohet, për nevoja të institucionit në një organizatë ndërkombëtare apo në një institucion ndërkombëtar;
 - 1.4. kur gjykata pezullon nëpunësin civil që është person zyrtar nga ushtrimi i detyrës;
 - 1.5. ndaj nëpunësit civil është iniciuar procedurë penale për kryerje të veprës penale gjatë ushtrimit të funksioneve të tij;
 - 1.6. nëpunësi civil mbahet në arrest apo paraburgim;
 - 1.7. deklarohet i zhdukur me vendim të gjykatës;
 - 1.8. regjistrohet si kandidat për zgjedhjet qendrore apo lokale;
 - 1.9. zyrtari zgjidhet dhe pranon detyrën në zgjedhjet qendrore apo lokale, përjashtimisht zyrtarët në pozitat të cilat janë me mandat;

- 1.10. ndodhet në gjendje konflikti të vazhdueshëm interesi, sipas ligjit të veçantë;
- 1.11. gjatë ndjekjes së ndonjë programi arsimimi apo trajnimi më të gjatë se tridhjetë (30) ditë, për nevojat e institucionit;
- 1.12. në raste të tjera, të parashikuara shprehimisht me legjislacionin në fuqi.

Neni 6

Kohëzgjatja e pezullimit sipas detyrës zyrtare

1. Pezullimi sipas detyrës zyrtare për rastet e përcaktuara në nenin 5 të kësaj Rregulloreje, bëhet për këtë kohëzgjatje:

- 1.1. deri në përfundim të procedurës disiplinore për pezullimin sipas nënparagrafit 1.1 të paragrafit 1, të nenit 5 të kësaj Rregulloreje;
- 1.2. për periudhën përkatëse të emërimit, për rastet e pezullimit sipas nënparagrafit 1.2 të paragrafit 1, të nenit 5 të kësaj Rregulloreje;
- 1.3. për kohëzgjatjen e transferimit sipas nënparagrafit 1.3 të paragrafit 1, të nenit 5 të kësaj Rregulloreje;
- 1.4. për kohëzgjatjen e përcaktuar në vendim për pezullim nga gjykata sipas nënparagrafit 1.4 të paragrafit 1, të nenit 5 të kësaj Rregulloreje;
- 1.5. deri në përfundimin e procedurës penale sipas nënparagrafit 1.5 të paragrafit 1, të nenit 5 të kësaj Rregulloreje;
- 1.6. deri në momentin e lirimit nga arresti apo paraburgimi për pezullimin sipas nënparagrafit 1.6 të paragrafit 1, të nenit 5 të kësaj Rregulloreje.
- 1.7. deri në shfaqjen e personit apo deklarin e vdekjes së tij me vendim të formës së prerë të gjykatës sipas nënparagrafit 1.7 të paragrafit 1, të nenit 5 të kësaj Rregulloreje.
- 1.8. pesë (5) ditë pas mbylljes zyrtare të fushatës sipas nënparagrafit 1.8 të paragrafit 1, të nenit 5 të kësaj Rregulloreje. Pezullimi në këtë rast duhet të bëhet së paku shtatë (7) ditë para hapjes zyrtare të fushatës.
- 1.9. deri në përfundimin e mandatit, sipas nënparagrafit 1.9 të paragrafit 1, të nenit 5 të kësaj Rregulloreje;
- 1.10. deri në transferimin e tij në një pozitë tjetër, me qëllim të shmangies së një konflikti të vazhdueshëm të interesit, në rastin e pezullimit sipas nënparagrafit 1.10 të paragrafit 1, të nenit 5 të kësaj Rregulloreje;

1.11. për periudhën që ndjek programin me shkëputje nga puna sipas nënparagrafit 1.11 të paragrafit 1, të nenit 5 të kësaj Rregulloreje. Pezullimi në këtë rast bëhet tridhjetë (30) ditë pas fillimit të programit të arsimit apo trajnimit.

Neni 7

Procedura për pezullimin sipas detyrës zyrtare

1. Nëpunësi civil në rastet sipas nënparagrafeve 1.2, 1.8 dhe 1.9 të paragrafit 1, të nenit 5 të kësaj Rregulloreje, duhet ta dërgoj dëshminë përkatëse në NjMBNj-në e institucionit ku nëpunësi ushtron detyrën.
2. Përjashtimisht paragrafit 1 të këtij neni, nëpunësi civil në kategorinë e nivelit të lartë drejtues në institucionet e administratës shtetërore, duhet të dërgojë dëshminë e emërimit në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik.
3. NjMBNj/DMZP duhet të pezullojë nga puna nëpunësit në të gjitha rastet sipas paragrafit 1 të nenit 5, me pranimin e dëshmisë zyrtare të shkakut të pezullimit.
4. Me qëllim të zbatimit të paragrafit 3 të këtij neni, NjMBNj/DMZP mund të kërkojë dëshmi nga institucionet, lidhur me ekzistimin e shkaqeve të pezullimit sipas paragrafit 1, të nenit 5 të kësaj Rregulloreje.
5. Gjatë periudhës së pezullimit, marrëdhënia e punës në shërbimin civil nuk mund të përfundojë dhe nuk mund të ndryshojë, përveç me kërkesën e nëpunësit të pezulluar ose kur parashikohet shprehimisht me LZP.
6. Nëpunësit civil i pushojnë të drejtat dhe detyrat nga puna dhe marrëdhënia e punës gjatë periudhës së pezullimit, përveç të drejtës për tu kthyer në vendin e punës.

Neni 8

Konstatimi i shkakut të pezullimit sipas detyrës zyrtare

1. Përveç kur përcaktohet ndryshe me LZP, pezullimi sipas detyrës zyrtare bëhet me vendim nga NjMBNj e institucionit, ku nëpunësi civil ushtron detyrën.
2. Përjashtimisht paragrafit 1 të këtij neni, Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik pezullon sipas detyrës zyrtare nëpunësin e kategorisë së lartë drejtuese në institucionet e administratës shtetërore.

Neni 9

Pezullimi vullnetar

1. Pezullimi vullnetar bëhet me kërkesë të nëpunësit civil në rastet si në vijim:

1.1. për kujdesin ndaj anëtarit të ngushtë të familjes, të moshuar ose të sëmurë për një periudhë deri në një (1) vit;

1.2. për përgatitje profesionale për një periudhë deri në dy (2) vite.

Neni 10 **Procedura për pezullimin vullnetar**

1. Kërkesa për pezullim për kujdesin ndaj anëtarit të ngushtë të familjes që është i moshuar ose i sëmurë, duhet shoqërohet me rekomandimin nga mjeku se personi ka nevojë për përkujdesje të vazhdueshme për një periudhë të caktuar.
2. Kërkesa për pezullim për përgatitje profesionale, duhet të shoqërohet me dëshminë nga institucioni përkatës që ofron përgatitjen profesionale.
3. Kërkesa për pezullim në rastet sipas nënparagrafit 1.1 të paragrafit 1, të nenit 9 të kësaj Rregulloreje, paraqitet me shkrim së paku pesë (5) ditë para datës së synuar të pezullimit.
4. Kërkesa për pezullim në rastet sipas nënparagrafit 1.2, të paragrafit 1, të nenit 9 të kësaj Rregulloreje, paraqitet me shkrim së paku tridhjetë (30) ditë para datës së synuar të pezullimit.
5. Kërkesa për pezullim i paraqitet NjMBNj-së së institucionit që pas shqyrtimit dërgohet tek zyrtari më i lartë administrativ i institucionit, i cili me vendim miraton apo refuzon kërkesën.
6. Kategoria e nivelit të ulët, të mesëm dhe të lartë drejtues, nuk kanë të drejtë në pezullimin vullnetar për përgatitje profesionale.
7. Në rast se nëpunësi civil që ka pezulluar marrëdhënien e punës për përgatitje profesionale krijon marrëdhënie tjetër pune, lirohet nga shërbimi civil.

Neni 11 **Efektet e pezullimit**

1. Pas përfundimit të pezullimit, përveç kur vendoset përfundimi i marrëdhënies së punës në shërbimin civil, sipas LZP-së, nëpunësi civil kthehet në pozitën e mëparshme të punës.
2. Në rast se pozita e mëparshme është e plotësuar përfundimisht, nëpunësi civil transferohet në një pozitë tjetër ekuivalente.
3. Nëpunësi i nivelit të ulët, të mesëm dhe të lartë drejtues në rastet sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, kthehet/transferohet në pozitë për periudhën e mbetur të mandatit për të cilin është emëruar.
4. Në rastin e pezullimit për një afat deri në tre (3) muaj, pozita e punës nuk plotësohet deri në përfundimin e pezullimit.
5. Ndërsa në rastin e pezullimit vullnetar për kujdesin ndaj anëtarit të ngushtë të familjes që është i moshuar ose i sëmurë, pozita nuk plotësohet deri në një (1) vit.

6. Për rastet e pezullimit si më poshtë, periudha e pezullimit llogaritet si përvojë pune në shërbimin civil:

6.1. kur ndaj nëpunësit është iniciuar procedurë disiplinore dhe komisioni disiplinor vendos se vazhdimi i ushtrimit të detyrës nga nëpunësi civil, pengon hetimin disiplinor apo mund të cenoj ushtrimin e përshtatshëm të detyrës së tij;

6.2. kur nëpunësi transferohet për nevoja të institucionit në një organizatë ndërkombëtare apo në një institucion ndërkombëtar;

6.3. kur nëpunësi ndodhet në gjendje konflikti të vazhdueshëm interesi sipas ligjit të veçantë, deri në transferimin e tij në një pozitë tjetër;

6.4. gjatë ndjekjes së ndonjë programi arsimimi apo trajnimi më të gjatë se tridhjetë (30) ditë, për nevojat e institucionit;

6.5. në rastin e pezullimit vullnetar për kujdesin ndaj anëtarit të ngushtë të familjes që është i moshuar ose i sëmurë;

6.6. në raste të tjera, të parashikuara shprehimisht me ligj.

7. Për rastet e pezullimit si më poshtë, periudha e pezullimit llogaritet si përvojë pune në shërbimin civil, nëse procedura penale përfundon dhe nëpunësi nuk shpallet fajtor:

7.1. kur gjykata pezullon nëpunësin civil që është person zyrtar nga ushtrimi i detyrës, për kushtet dhe shkaqet e parapara në legjislacionin përkatës në fuqi;

7.2. ndaj nëpunësit civil është iniciuar procedurë penale për kryerje të veprës penale gjatë ushtrimit të funksioneve të tij;

7.3. nëpunësi civil mbahet në arrest apo paraburgim;

7.4. deklarohet i zhdukur deri në shfaqjen e personit apo deklarimit të vdekjes me vendim gjykatës.

8. Nëpunësi civil gjatë periudhës së pezullimit nuk përfiton pagë.

9. Përjashtimisht paragrafit 8 të këtij neni, nëpunësi përfiton pesëdhjetë për qind (50 %) të pagës bazë si në vijim:

9.1. deri në gjashtë (6) muaj në këto raste:

9.1.1. kur ndaj nëpunësit është iniciuar procedurë disiplinore dhe komisioni disiplinor vendos se vazhdimi i ushtrimit të detyrës nga nëpunësi civil, pengon hetimin disiplinor apo mund të cenoj ushtrimin e përshtatshëm të detyrës së tij;

9.1.2.gjatë ndjekjes së ndonjë programi arsimimi apo trajnimi më të gjatë se tridhjetë (30) ditë për nevojat e institucionit;

9.2. deri në përfundim të pezullimit në këto raste:

9.2.1.kur gjykata pezullon nëpunësen/in civil që është person zyrtar nga ushtrimi i detyrës, për kushtet dhe shkaqet e parapara në legjislacionin përkatës në fuqi;

9.2.2.ndaj nëpunëses/it civil është iniciuar procedurë penale për kryerje të veprës penale gjatë ushtrimit të funksioneve të tij;

9.2.3.nëpunësi civil mbahet në arrest apo paraburgim;

9.2.4.deklarohet i zhdukur deri në shfaqjen e personit apo deklarimit të vdekjes me vendim të gjykatës.

10. Në rast se procedura disiplinore apo procedura penale përfundon pa një masë disiplinore, gjegjësisht dënim penal, nëpunësit civil që ka qenë i pezulluar me pesëdhjetë për qind (50%) të pagës së tij, i kompensohet pjesa e ndaluar e pagës bazë.

Neni 12 Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja Nr. 01/2011 për Ndërprerjen, Pezullimin dhe Përfundimin e Marrëdhënies së Punës në Shërbimin Civil.

Neni 13 Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

04 tetor 2024

